



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 144 Prot.

Patos, më 18/01 /2024

PROJEKT-VENDIM

Nr. 03, datë 18/01 /2024

PËR NJË SHITESË NË VKB NR. 41 DATË 27.07.2023 “ PËR RISHQYRTIMIN, MIRATIMIN DHE PËRBËRJEN E KRYESISË SË KOMISIONEVE TË PËRHERSHME”.

KËSHILLIT TË BASHKISË PATOS

Në mbështetje të nenit 54 shkronja “a”, të ligjit nr. 139 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, VKB nr. 18, datë 22.04.2020 “Për miratimin e rregullores së Këshillit të Bashkisë Patos” nenet 29, 30, 31, 33, 34, 35, 37 ju paraqesim :

PËR DISKUTIM DHE MIRATIM

1. Për një shtesë në VKB nr. 41 datë 27.07.2023 “ për rishqyrtimin , miratimin dhe përbërjen e kryesisë së komisioneve të përhershme” si më poshtë vijon,

KOMISIONI I INTEGRIMIT EUROPIAN

- | | |
|-------------------------|-------------|
| 1. Z. Novrus Toska | Kryetar |
| 2. Z. Renaldo Shpata | Zv/ Kryetar |
| 3. Znj. Lori Musaj | Anëtare |
| 4. Znj. Liljana Mesutaj | Anëtare |
| 5. Z. Zejni Musaj | Anëtar |

Misioni Komisionit të Integrimit Evropian.

1. Të mbështesë dhe koordinojë strukturat e bashkisë, në realizimin e reformave për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga procesi i anëtarimit në BE. Të monitoroj programimin dhe zbatimin me efikasitet të gjithë financimeve në kuadër të programeve të BE-së dhe donatorëve të tjerë, nga të cilat përfiton bashkia.

2. Komisioni merr në shqyrtim raportin e vlerësimit të performancës së bashkive në procesin e integrimit evropian cili hartohet dhe raportohet cdo vit kalendarik.

Adresa: Lagjja “Naftetari”, Rruga “Unaza”, Patos

3. Këshilltarët janë pjesë e aktiviteteve që Kryetari i Bashkise me mbështetjen e strukturës së Integritimit European organizojnë në Bashki, në bashkepunim me strukturat e qeverisë qëndrore, Delegacionin e BE në Tiranë si dhe përfaqësitë e vendeve anëtare të BE-se.

4. Këshilltarët njihen me ecurinë e projekteve të financuara nga fondet e BE-se, të cilat janë pjesë e projekteve të bashkisë dhe donatorëve të tjerë, nëpërmjet raporteve të përgatitura 2 herë në vit nga administrata e bashkisë.

5. Këshilltarët mund të kërkojnë një seancë konsultimi më të gjithë aktorët lokalë dhe Kryetarin e Bashkisë për të diskutuar rezultat mbi performancën e bashkisë bazuar në vlerësimin vjetor të performancës së bashkive në procesin e integritimit evropian, si dhe masat që duhet të ndërmerren për ato aspekte të vlerësimit ku Bashkia duhet të përformoj më mirë.

SEKRETARI
Refaela Xeba



KRYETARI
Armand Ahmetaj

